



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:071641

Datë: 22.07.2019

Numri i dokumentit: 00420817

P.nr. 19/2019

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit A. M. nga fshati, Komuna e Novobërdës, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.1973/2018, të datës 20.12.2018, jashtë seance dhe sipas detyrës zyrtare, me datën 22.07.2019, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. HUDHET poshtë aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr.1973/2018, të datës 20.12.2018 dhe PUSHOHET procedura penale ndaj të të pandehurit A. M. nga fshati, Komuna e Novobërdës, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës për shkak se vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri nuk përbën vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës me numër 06/L-074, të hyrë në fuqi me datë 14.04.2019.
- II. E dëmtuara N. S. nga Gjilani, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.
- III. Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 20.12.2018, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.1973/2018, kundër të të pandehurit A. M. nga fshati Komuna e Novobërdës, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës.

Gjykata duke vepruar sipas detyrës zyrtare si dhe duke u bazuar në Kodin Penal të Republikës së Kosovës me numër 06/L-074, të datës 13.12.2018, të miratuar nga ana e Kuvendit i Republikës së Kosovës ndërsa i hyrë në fuqi me datë 14.04.2019, gjeti se veprimet inkriminuese të të pandehurit të lartcekur, nuk përbëjnë vepër penale sipas nenit 370 paragrafi 1 të KPRK-ës, sipas të cilit “Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt dëm të

konsiderueshëm pasuror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”, çka nënkupton se veprimet të cilat kanë pasur si pasojë shkaktimin e lëndimit të lehtë trupor të kryer me rastin e shkeljes së ligjit mbi trafikun publik apo transportit rrugor e të cilat kanë qenë të parapara në nenin 378 paragrafi 1 të KPRK-ës së shfuqizuar dhe për të cilën vepër akuzohet i pandehuri, sipas nenit 370 paragrafi 1 të KPRK-ës nuk përbëjnë vepër penale.

Bazuar edhe në nenin 3 paragrafi 2 të KPRK-ës në të cilin thuhet se “Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm”, si dhe faktin se zbatimi i veprimit retroaktiv të ligjit është obligim i gjykatës dhe se me rastin e ndryshimit të ligjit duhet të zbatohet ligji më i favorshëm për të pandehurin, gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret veprimet inkriminuese të parapara në nenin 378 paragrafi 1 të KPRK-ës së shfuqizuar (përkatësisht shkaktimi i lëndimit të lehtë trupor me rastin e shkeljes së ligjit mbi trafikun publik apo transportit rrugor) sipas kodit të ri penal përkatësisht nenit 370 paragrafi 1 të KPRK-ës, nuk paraqesin vepër penale dhe si rrjedhojë ndaj kryesve të këtyre veprave penale më nuk mund të ndërmerret ndjekja penale dhe as t’iu shqiptohet dënimi i paraparë ligjor.

Andaj gjykata në bazë të nenit 253 paragrafi 1 pika 1.1 të KPP-së dhe nenit 3 paragrafi 2 të KPRK-ës, vendosi që të hedhë poshtë aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe ndaj të pandehurit të lartcekur të pushohet procedura penale për veprën penale e cila iu vihet në barrë.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.19/2019, më datë 22.07.2019

Zyrtarja ligjore
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermaxhaj

KËSHILLA JURIDIKE Kundër këtij aktvendimi, mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit. Ankesa ushtrohet nëpërmes kësaj gjykate.